




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 10, paragrafët 10.1 dhe 10.2, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 06/2009 për Vulën rrethore, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë :

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për marrjen e lejes për vule rrethore (3 ekzemplarë) për Drejtorinë e Kadastrit.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, anëtarë të komisionit janë:
 1. Albina Blakaj, shefe e Sektorit të Gjeodezisë në kuadër të Drejtorisë së Kadastrit kryesuese;
 2. Nefi Krasniqi, shef i Sektorit të Qendrës për shërbim me qytetarë në kuadër të Drejtorisë së Administratës, anëtar;
 3. Leonora Sadiku Tupalla , zyrtare ligjore në kuadër të Sektorit Ligjor, anëtare.
- III. Detyrë e komisionit të cekur si në pikën I të këtij Vendimi është zhvillimi i procedurave për marrjen e lejes për vule rrethore për Drejtorinë e Kadastrit (3 ekzemplarë), porositjen e vulës të vulëpunuesi si dhe veprime të tjera të parapara sipas legjislacionit të cekur si në preambulën e këtij Vendimi.
- IV. Komisioni i cekur si në pikën I të këtij vendimi, harton procesverbal për çdo veprim procedural të ndërmarrë.
- V. Për kryerjen e detyrave të cekura si në pikën III të këtij Vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama